



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.92/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj, dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK)), me seli në Komuna Prishtinë, të parashtruar kundër subjektit politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin, me seli në Drenas, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale, në Republikën e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më 03.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.92/2025, e datës 01.10.2025, paraqitur kundër subjektit politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin, me seli në Drenas, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 01.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër ZL.Anr.92/2025, nga subjekti politik PDK, me të cilën pretendon se kandidati për kryetar të Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci nga radhët e subjektit politik PDKRL përmes një postimi ka bërë mashtrim, keqinformim dhe lajthitje të opinionit publik dhe elektoratit në Komunën e Drenasit, përmes keqpërdorimit të emrit dhe identitetit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK).

Deklarata e datës 30 shtator 2025, si në vijim e Ramiz Lladrovcit, kandidatit për kryetar nga subjekti politik "Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin: "Ramiz Lladrovci iprin listës "Për Drenasin Kampion", dhe më 12 tetor, pas fitores sonë, do të jem në zyrat e Partisë Demokratike të Kosovës (. .). Zgjedhjet i fiton vetëm Partia Demokratike e Kosovës, e cila është këtu (tregon me gisht nga vetja), në zemër, dhe që e kam bërë krenare për 7 Vite rresht. (...) Dhe unë jam Partia Demokratike. I njëjti në mënyrë të përsëritur dhe të

qëllimshme, z. Lladrovci, në paraqitjet e tij publike, përfshirë intervista televizive, fjalime në tubime zgjedhore, si dhe postime në rrjetet sociale, vazhdon të deklarohet si pjesë e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK).

Më tej në ankesë theksohet se Z. Ramiz Lladrovci, kandidat për kryetar të Komunës së Drenasit, garon në Zgjedhjet Lokale si përfaqësues i subjektit politik "Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrofin", subjekt i regjistruar dhe i certifikuar nga KQZ.

Ndërsa i njëjti në disa prej deklaratave më domethënëse që ka theksuar publikisht: "Nuk ka bir nëne që më largon nga PDK"; "Unë jam më PDK se shumica e anëtarëve të Kryesisë dhe deputetëve të saj"; si dhe deklarata të tjera me përmbajtje të ngjashme, të cilat gjenden gjerësisht në median elektronike dhe rrjetet sociale.

Sipas parashtruesit të ankesës rasti më i fundit kur z. Lladrovci keqpërdori emrin e Partisë Demokratike të Kosovës për qëllime mashtrimi, dezinformimi dhe lathitjeje të opinionit publik, ishte kur me date 30 shtator 2025 në Drenas, deklaroi publikisht se: "Ramiz Lladrovci i prin listës "Për Drenasin Kampion dhe më 12 tetor, pas fitores sonë, do të jem në zyrat e Partisë Demokratike të Kosovës (...). Zgjedhjet i fiton vetëm Partia Demokratike e Kosovës, e cila është këtu (tregon me gisht nga vetja), në zemër, dhe që e kam bërë krenare për 7 Vite rresht (...) Dhe unë jam Partia Demokratike."

Këto deklarime publike dhe të përsëritura përbëjnë keqpërdorim të emrit dhe identitetit politik të PDK-së, me qëllim të mashtrimit, keqinformimit të elektoratit dhe krijimit të një perceptimi të rremë se kandidatura e tij gëzon mbështetjen zyrtare të Partisë Demokratike të Kosovës, gjë që nuk përkon me të vërtetën.

Në ankesë parashtruesi ka sqaruar se kandidati zyrtar i Partisë Demokratike të Kosovës për kryetar të Komunës së Drenasit, i certifikuar nga KQZ, është z. Petrit Hajdari. Dhe se Z. Lladrovci, nuk ka asnjë lidhje ligjore, politike apo organizative me Partinë Demokratike të Kosovës. Përkundrazi, ai është subjekt politik kundërshtar i PDK-së në këto zgjedhje. Për më tepër, z. Lladrovci është shkarkuar zyrtarisht nga pozita e u.d. kryetarit të Degës së PDK-së në Drenas, me vendim të Kryesisë së PDK-së, dhe në vend të tij është emëruar z. Petrit Hajdari. Ky vendim është i dokumentuar dhe i protokolluar nga organet kompetente të partisë.

Sjellja e përshkruar më sipër e z. Ramiz Lladrovci përbën dezinformim të drejtpërdrejtë të elektoratit dhe, për më tepër, dëmton integritetin e procesit zgjedhor përmes keqpërdorimit të emrit, historisë dhe identitetit të një subjekti politik tjetër, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Duke pretenduar publikisht se është përfaqësues i një partie që nuk e ka nominuar dhe nuk e mbështet, ai ka krijuar një mjegullim të qëllimshëm të identitetit të tij politik, duke rrezikuar që një numër i konsiderueshëm i qytetarëve të mashtrohen lidhur me përkatësinë e tij reale subjektive në momentin e votimit. Kjo sjellje përbën Shkelje serioze të parimeve të garës së ndershme dhe të informimit të saktë të votuesve.

Këto veprime bien në kundërshtim të qartë me nenin 32 Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës që përcakton qëllimin e Kodit të Sjelljes.

Ky nen përcakton: "Kodi i Sjelljes për subjektet politike dhe mbështetësit e tyre dhe kandidatët ka për qëllim krijimin e kushteve në të cilat populli i Kosovës mund të zgjedhë përfaqësuesit e tij përmes zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirë-informuara, në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit. " (theksi shtuar).

Një pjesë e konsiderueshme e elektoratit, sidomos ata që tradicionalisht kanë mbështetur PDK-në në komunën e Drenasit, mund të keqinformohen dhe të besojnë se vota e tyre për subjektin "Për Drenasin Kampion me Ramiza Lladrovcin" është në të vërtetë votë për PDK-në. Kjo bie ndesh me parimin themelor të zgjedhjeve të mirë-informuara, të sanksionuar në nenin 32 të Ligjit, sepse i privon qytetarët nga e drejta për të marrë vendime zgjedhore të bazuara në informata të sakta dhe transparente, konkurrencë të ndershme ndërmjet kandidatëve dhe subjekteve politike, ku secili garues përfaqëson qartë identitetin dhe ofertën e tij politike. Kur një kandidat përdor emrin dhe reputacionin e një partie tjetër për të ndërtuar përkrahjen elektorale, pa pasur përkrahje formale nga ajo parti, ai e Shkel barazinë në garë dhe e vendos veten në një pozitë të padrejtë përballë kandidatëve të tjerë, veçanërisht përfaqësuesin zyrtar të PDK-së. Kërkojnë që të merret parasysh edhe fakti se kjo deklaratë përfaqëson një vazhdimësi të një sjelljeje të përsëritur nga z. Lladrovci gjatë gjithë fushatës zgjedhore, siç është sqaruar më sipër në këtë ankesë

PZAP-i më datë 01.10.2025 subjektit politik, PDKRL, i ka dërguar Kërkesë për përgjigje në ankesë, mirëpo i njëjti në afatin e paraparë deri më 02.10.2025 në ora 15:00 nuk është përgjigjur.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa-PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës, dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoj se pretendimet në ankesë nga subjekti politik PDK, se kandidati për kryetar të Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci nga radhët e subjektit politik "Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin", me postimin e tij në rrjetin social facebook duke keqpërdorur emrin e Partisë Demokratike të Kosovës për qëllime mashtrimi, dezinformimi dhe lathitjeje të opinionit publik, ishte kur me date 30 shtator 2025 në Drenas, deklaroi publikisht se citim: "*Ramiz Lladrovci i prin listës "Për Drenasin Kampion dhe më 12 tetor, pas fitores sonë, do të jem në zyrat e Partisë Demokratike të Kosovës (...). Zgjedhjet i fiton vetëm Partia Demokratike e Kosovës, e cila është këtu (tregon me gisht nga vetja), në zemër, dhe që e kam bërë krenare për 7 Vite rresht (...) Dhe unë jam Partia Demokratike"* janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 32 të Ligjin Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës -së, me të cilën përcaktohet se: "*Kodi i Sjelljes për subjektet politike dhe mbështetësit e tyre dhe kandidatët ka për qëllim krijimin e kushteve në të cilat populli i Kosovës mund të zgjedhë përfaqësuesit e tij përmes zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirë-informuara në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit"*. Po ashtu sipas panelit të njëjtat

deklarime nuk përbëjnë shkelje të dispozitave të nenit 34 të Ligjin Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, të pretenduara nga ankuesi, pasi që me të njëjtat deklarime nuk ka kurrfarë nxitje të urrejtjes kundrejt subjektit tjetër politik.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Ladrovci - PDKRL, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që në postimin e kandidatit të PDKRL - për kryetar të Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, sipas vlerësimit të Panelit, nuk përbën mashtrim ose keqinformim të elektoratit, si dhe nuk përbën dezinformim të drejtpërdrejtë të elektoratit dhe për më tepër, nuk dëmton integritetin e procesit zgjedhor përmes përdorimit të emrit, historisë dhe identitetit të një subjekti politik tjetër, në rastin konkret Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Sipas vlerësimit të Panelit këto deklarime janë deklarime të dhëna në vazhden e diskutimit lidhur me çështjen e largimit të kandidatit në fjalë nga ana e subjektit politik ankues (PDK), pasi që është fakt notor se kandidati Ramiz Ladrovci ka qenë pjesë e këtij subjekti politik në të kaluarën, e kurrësi të njëjtat deklarime nuk mund të kenë ndikim dëmtrimin e integritetit të procesit zgjedhor.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar, pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 par.3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 pa. 1 të Ligjin Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.92/2025 më datën 03.10.2025

Kryesues i Panelit,
Arsim Hamzaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të Ligjin Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykata Supreme të Kosovës, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.89/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryetar i kolegjit, Delushe Halimi dhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të parashtruar kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.92/2025, të datës 03.10.2025, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 tetor 2025, në seancën e mbajtur më datë 09.10.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e subjektit politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, ndërsa vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.92/2025, i datës 03.10.2025, VERTETOHET.

A r s y e t i m i

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin ZL.Anr.92/2025, të datës 03.10.2025, ka vendosur: “Refuzohet e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, ZL.Anr.92/2025 e datës 01.10.2025 paraqitur kundër subjektit politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin me seli në Drenas, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës”.

Kundër vendimit të lartpërmendur, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, pa specifikuar bazën konkrete apo shkeljet e vendimit të kontestuar të PZAP-së, me propozim që Gjykata Supreme të shpall ankesën e pranueshme dhe të anuloi vendimin ZL.Anr.92/2025 të PZAP-së, të shqiptojë gjobë ndaj z.Ramiz Lladrovcit dhe subjektit të tij politik “Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin” për shkeljet e konstatuara, t’i Ndalohet z.Lladrovcit përdorimi publik i emrit, logos, simboleve apo përfaqësimit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në fushatë në deklarime publike dhe materiale zgjedhore.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore dhe propozon që ankesa e subjektit politik, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi i ankimuar.



Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 01.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka paraqitur ankesë në PZAP kundër subjektit politik “Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin” respektivisht kandidatit për kryetar nga ky subjekt Ramiz Lladrovci për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes nga ana e kryetarit të këtij subjekti respektivisht kandidatit për kryetar nga subjekti në fjalë me pretendimin se gjatë fushatës personi në fjalë Ramiz Lladrovci me rastin e adresimit qytetarëve me datë: 30 shtator 2025 ka deklaruar: “ *Ramiz Lladrovci i prin listës Për Drenasin Kampion, dhe me 12 tetor pas fitores sonë do të jemë në zyrat e Partisë Demokratike të Kosovës, Zgjedhjet i fiton vetëm Partia Demokratike e Kosovës, e cila është këtu (tregon me gisht ka vetja) në zemër dhe që e kam bërë krenare për 7 vite rresht dhe unë jam Partia Demokratike*”, në një deklaratë tjetër ka deklaruar se: “ *Nuk ka bir nane që më largon nga PDK*” Unë jam më PDK se shumica e anëtarëve të Kryesisë dhe deputetëve të saj”. Me këto deklarime sipas subjektit ankues është keqpërdor emri dhe identiteti i subjektit politik PDK, PDK-ja ka kandidat për kryetar Petrit Hajdari, Lladrovci është shkarkuar zyrtarisht nga pozita e Ud.Kryetarit të degës së PDK-së në Drenas, këto përpjekje sipas subjektit ankues duke e paraqitur vetën si anëtar apo përfaqësues i kësaj partie përbënë dezinformim dhe manipulim publik, cenohet respekti për sundimin e ligjit, atmosfera e tolerancës demokratike dhe paqes dhe veprimet e tilla përbëjnë shkelje të nenit 2 dhe nenit 34 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe shkelje serioze të Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, me vendimin ZL.Anr.92/2025, të datës 03.10.2025, ka refuzuar të pabazuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: pretendimet e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 32 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, me të cilën përcaktohet se: “ Kodi i Sjelljes për subjektet politike dhe mbështetësit e tyre dhe kandidatët ka për qëllim krijimin e kushteve në të cilat populli i Kosovës mund të zgjedh përfaqësuesit e tij përmes zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirë informuara në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit”. Po ashtu PZAP-i më tutje shtoi se deklaratimet nuk përbëjnë shkelje të dispozitave të nenit 34 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në republikën e Kosovës të pretenduara nga ankuesi pasi që me të njëjtat deklarime nuk ka kurrfarë nxitje të urrejtjes kundrejt subjektit tjetër politik. Paneli ka vlerësuar edhe faktin se deklaratimet e subjektit politik “Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin” nuk përbëjnë mashtrim ose keqinformim të elektoratit si dhe nuk përbën dezinformim të drejtpërdrejt të



elektoratit dhe për më tepër nuk dëmtojnë integritetin e procesit zgjedhore përmes përdorimit të emrit, historisë dhe identitetit të një subjekti politik tjetër. Krejt në fund Paneli ka vlerësuar se ankesa e subjektit ankues është e pabazuar sepse nga provat e bashkangjitura nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 par. 3, neni 118 par. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të vendimit të saj.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka refuzuar të pabazuar ankesën e subjektit politik Partia Demokratike Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 tetor 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore. Veprimet e Ramiz Lladrovci nga subjekti politik *“Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin”* të shprehura përmes deklaramit si vijon: *“Ramiz Lladrovci i prinë listës Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin dhe me 12 tetor pas fitores sonë, do të jemë në zyrat e Partisë Demokratike të Kosovës(...) Zgjedhjet i fiton vetëm Partia Demokratike e Kosovës e cila është këtu (tregon me gisht nga vetja) në zemër dhe që e kam bërë krenare për 7 vite rresht.. Dhe unë jam Partia Demokratike”* si dhe deklarimi se: *“Nuk ka birë nane që më largon nga PDK, Unë jam më PDK se shumica e anëtarëve të kryesisë dhe deputetëve të saj”* nga këndvështrimi analitik i Gjykatës Supreme këto deklarime si të tilla janë të pa përshtatshme dhe jo korrekte, mirëpo të njëjtat nuk plotësojnë kushtet ligjore për tu konsideruar të ndaluara sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, më konkretisht Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike dhe Kandidatët.

Veprimet e ndaluara të shprehura qoftë përmes deklaramive verbale, në të shkruar apo forma të tjera të komunikimit me publikun, për tu trajtuar të ndaluara duhet të sanksionohen me dispozita përkatëse ligjore. Neni 32 i Ligjit nr.08/L-228 përcakton se: *“Kodi i Sjelljes për subjektet politike dhe mbështetësit e tyre dhe kandidatët ka për qëllim krijimin e kushteve në të cilat populli i Kosovës mund të zgjedhë përfaqësuesit e tij përmes zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirë-informuara në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.”* Ky nen përcakton bazamentin e parimeve të sjelljes së subjekteve politike, kandidatëve, mbështetësve, me qëllim të krijimit të kushteve për zgjedhje të lira, demokratike, të mirë informuara në frymën e tolerancës. Si veprime të ndaluara të përcaktuara në mënyrë taksative i rregullon neni 34 i po të njëjtit ligj e me të cilin përcaktohet se: *“1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërs si në vijim: 1.1. heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posterit ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik; 1.2. vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat*



ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve; 1.3. mbajtja ose ekspozimi i armëve të secilit lloj gjatë tubimeve politike ose gjatë çfarëdo lloj ngjarjeje që ka lidhje me aktivitetet e subjekteve politike. Mbjtja e armëve nga personat e tjerë gjatë tubimeve politike/manifestimeve lejohet vetëm në rast se personat që mbajnë armë të tilla janë të autorizuar për një gjë të tillë nga autoritetet përkatëse dhe që Policia e Kosovës është njoftuar paraprakisht se të tilla armë do të mbahen në tubimet e caktuara; 1.4. çrregullimi i tubimeve të subjekteve tjera politike ose nxitja e të tjerëve për një veprim të tillë; 1.5. pengimi ose tentimi për pengimin e gazetarëve për të përmbushur detyrat e tyre profesionale; 1.6. premtimi i ndonjë shpërblimi financiar me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve; 1.7. kërcënimi ose tentimi për të kërcënuar subjektet tjera politike, përkrahësit ose kandidatët e tyre; 1.8. nxitja e cilitdo person për të votuar në zgjedhje, i cili nuk ka të drejtë vote; 1.9. nxitja e personit për të votuar më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje ose të votojë në emër të një personi tjetër; 1.10. abuzimi me të drejtën e ankesës, ose duke bërë ankesa ose paraqitje të rrejshme, të pavlera dhe irrituese në PZAP; 1.11. përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë.”

Gjykata Supreme vlerësoi deklaratimet në fjalë dhe nuk gjeti se të njëjtat bien ndesh as me nenin 34 të cituar si më lartë, pasi që deklaratimet e tilla përkundër faktit se siç u potencuar më lartë në vetvete “nuk janë të përshtatshme” dhe jo korrekte, kjo apriori nuk i kategorizon dhe sanksionon si të ndalueshme juridikisht, pasi të njëjtat në brendi apo përmbajtje nuk nxisin urrejtje, nuk bëjnë thirrje për dhunë, nuk cenojnë aspektin e zgjedhjeve të mirë informuara, nuk cenojnë integritetin zgjedhor as nuk cenojnë zgjedhjet e lira dhe demokratike, të njëjtat nuk shkaktojnë konfuzion në raport me votuesit në drejtim të përfaqësimit të subjekteve politike se kush është kandidat për kryetar nga subjekti ankues PDK, e po ashtu nuk e cenojnë tolerancën e procesit zgjedhor. Këto deklarime përbëjnë një frustrim të personit në fjalë karshi “hatër mbetjeve” me subjektin ankues rreth përcaktimit të kandidatit për kryetar nga subjekti ankues PDK. Fakti se personi në fjalë deklaroi se është PDK-, apo më PDK se të tjerët, kjo në asnjë mënyrë nuk mund të ndikon në konfuzionin e votuesit sepse PDK-ja si subjekt qartë dihet se kandidon me një kandidat tjetër, ndërsa personi në fjalë Lladrovci ka themeluar subjekt tjetër dhe se të gjithë votuesit mjaftueshëm janë njoftuar përmes organeve përgjegjëse si dhe mjeteve të informimit se cilët janë kandidatët për kryetar komune dhe cilin subjekt politik e përfaqësojnë ata kandidatë. Përcaktimi i ndalesave respektivisht veprimeve të ndaluara gjatë zgjedhjeve gjithnjë duhet të përcaktohet qartë me ligj, në të kundërtën nuk mund të tërheq përgjegjësi dhe sanksion sepse kjo përbën pastaj cenim të rendit juridik në përgjithësi por edhe Parimeve Zgjedhore në veçanti.

Mbi barrën e provës dhe standardin ligjor, sipas nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme: “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse, dhe barra e provës bie mbi palën ankuese.” Në këtë rast, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), nuk ka provuar se deklaratimet e kandidatit Ramiz Lladrovci nga subjekti “Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin” janë veprime të ndaluara konform nenit 32 dhe 34 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.



Gjykata vlerëson se PZAP ka vepruar në përputhje me ligjin dhe ka vlerësuar drejt faktet dhe provat në shkresat e lëndës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
AA.nr.89/2025, datë 09.10.2025.

Kryetari i kolegjit,
Faton Ademi



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Gjyqësori radnik




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS / СУДСКИ САВЕТ КОСОВЕ / KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

SEKRETARATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-89/2025

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ka është dashur të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës, iqind, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto prinitiac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni pošto ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena: odraslom članu domaćin. Prinaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngritur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto prinitiac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde prinitiac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____ cas.
dani _____ u _____ cas.
Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijma _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - poipis dostavljaca

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

ALTTGULLIHI

09 10 2025

Numri i shtojcave: _____
broj priloga _____

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovinia)

Marrësi: M. K. 2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i anij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Poipis prinitiac ili licn koje je
pismeno primilo u znanju) 076
08/05

Nënshkrimi i dorëzuesit - poipis dostavljaca

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebne precrtati)

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkakuin pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpise, potpisuje ga dostaljac, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.